

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 15.11.2018

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nënparagrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, pasi shqyrtoi raportin me rekomandime për Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Shtimes, Këshilli në mbledhjen e njëzet e tretë (XXIII) të mbajtur më datë 15.11.2018 mori këtë:

VENDIM

1. Miratohet raporti me rekomandime i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Shtimes.
2. Obligohet Kryetari i Komunës së Shtimes për zbatimin e rekomandimeve në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandim i Kolegjit të Këshillit lidhur me Monitorimin të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Komunën e Shtimes, është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve në pajtim me këtë vendim dhe raportin.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.

Vendimi i dërgohet:


- Kryetarit të Komunës së Shtimes;
- Menaxherit të Personelit të Komunës së Shtimes dhe
- Arkivit të Këshillit.

Eshref SHABANI
Kryetar i Këshillit





OPREDELBA E PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi i Dorëzuar Primenat/Pradato Recieved/Submitted	30.11.2018	vit year	
Organizimi Org./Unit	Nr. Prot. Br. Prot.	Prilog Appendix	Kopje Kopina Quantity
SKPMSHCK	7245/2018		1/10

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**RAPORTI I MBIKËQYRJES SË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL
KOMUNA E SHTIMËS**

**PËR VITIN
2017**

Prishtinë, 2018

Faqe 1 nga 10

*Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
Adresa: „Sheshi Nëna Terezë”, Ish-ndërtesa e Gërmisë, p.n. 10000, Prishtinë. Nr. tel: 038 212 331
<https://kpmshc.rks-gov.net/>*



TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
FUNKSIONI MBIKQYRËS I KËSHILLIT	3
OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES	3
FUSHAT E MBIKËQYRJES	3
RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË KOMUNËN E SHTIMËS	5
I. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE	6
II. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT	6
III. PROCEDURAT DISIPLINORE	6
IV. PROCEDURAT E ANKESAVE	7
V. PROCEDURAT E VLERËSIMIT	7
VI. PROCEDURAT E PUSHIMEVE	7
VII. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT	7
VIII. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA	8
IX. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS	8
X. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK	9
XI. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS	9
XII. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVILË	9
XIII. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET	9
XIV. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT	10
XV. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLUZIONET E PËRGJITHSHËM PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL	10

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) mbikëqyrë rregullat dhe parimet e shërbimit civil të Kosovës.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregullorja Nr. 02/2016 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2014 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MBIKËQYRËS I KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2016 për Procedurën e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Institucionet e Administratës Publike, përmes funksionit të mbikëqyrjes Këshilli bënë mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar “Udhëzuesin për procedurën e mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil”, mbi bazën e të cilit edhe harton “Planin e Mbikëqyrjes” në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MBIKËQYRJES

Objektiva e mbikëqyrjes ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MBIKËQYRJES

Këshilli, gjatë implementimit të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e mbikëqyrjes në kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

RAPORT PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL NË KOMUNËN E SHTIMËS

Këshilli, gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Komunën e Shtimës, për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Komuna e Shtimës përveç mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës me datë 08.10.2018, në prezencë të Menaxherit të Personelit, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Vendimi i datës 23.07.2015 me 02/1Nr.142;
- Akt emërimi i datës 24.01.2011 me 02/Nr.14/12;
- Plani vjetor i trajnimit të nëpunësve civil janar-dhjetor 2017;
- Aktvendimi i datës 29.05.2017 për pushim pa pagesë;
- Aktvendimi mbi pezullimin e dakorduar të marrëdhënies së punës;
- Vendimi 02/Nr.02 i datës 04.01.2017 për transferim të përhershëm;
- Njoftimi i datës 01.12.2017 për vlerësimin e nëpunësve civilë;
- Aktvendimi i datës 21.10.2016 për Themelimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave;
- Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 27.07.2017;
- Aktvendimi i datës 21.10.2016 për Themelimin e Komisionit Disiplinor;
- Dosja e nëpunësit civil për pozitën “Zyrtar për Zhvillim”
- Dosja e nëpunësit civil për pozitën “Zyrtare e Zyrës së Prokurimit”.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e mbikëqyrjes të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

I. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Komunën e Shtimës me datë 08.10.2018, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe se klasifikimi dhe sistematizimi i vendeve të punës është bërë në pajtim me organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Gjatë vizitës Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar tri (3) dosje të nëpunësve civil: Përgjegjës i Sektorit-Zyrtar për Ndërtim, Zyrtare e Zyrës së Prokurimit, Zyrtare për Zhvillim, të cilat kanë qenë në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civilë.

Ushtuesit e detyrës: Gjatë vizitës Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Shtimës për vitin 2017 nuk ka pasë nëpunës të caktuar ushtues të detyrës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

II. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Shtimës gjatë vitit 2017 ka zhvilluar një (1) procedura të rekrutimit për vendin e punës “Zyrtar për Zhvillim”, për të cilin proces të rekrutimit ka vendos Kolegji për shqyrtimin e ankesave, me ankesën numër A/02/447/2017 të datës 21.09.2017.

Marrveshjet për shërbime të veçanta: Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Komuna e Shtimës gjatë vitit 2017 ka pasë dy (2) të angazhuar nëpunës me shërbime të veçanta për vendin e punës “Zjarrëfikës” në kuadër të Njësisë së Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit në Shtime, dh i ka zhvilluar procedurat e thjeshtëzuara të rekrutimit.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

III. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor është i themeluar me Aktvendimin 02/Nr.428 të datës 21.10.2016 dhe është në pajtim me dispozitat e nenit 70 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Shtimës, e ka pas një (1) rast në Komision Disiplinor, për të cilin rastë është vendosur nga kolegji i Këshillit për shqyrtimin e ankesave, me vendimin numër A.nr.85/2018 të datës 06.04.2018.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

IV. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Shtimës, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është i themeluar me Aktvendimin 02/Nr.427 të datës 21.10.2016 dhe është në pajtim me dispozitat e nenit 82 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2017 në Komunën e Shtimës janë zhvilluar dy (2) procedura të ankesave ndaj nëpunësve civil, për të cilat ankesa është vendosur nga Kolegjet e Këshillit për shqyrtimin e ankesave.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

V. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Shtimës, e ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civilë.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të procedurave të vlerësimit për vitin 2017 konstaton se vlerësimi i punës për nëpunësen në vendin e punës “Zyrtare e Prokurimit” në formularin e vlerësimit nuk është shënuar data e vlerësimit kur është bërë nga vlerësuesi e as nga vlerësuesja se kur e ka marrë vlerësimin e punës.

REKOMANDIMI 1:

Kryetarin e Komunës së Shtimës, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për eliminimin e shkeljes, që të bëhet vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civilë, ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe vlerësimi i nëpunësve civil të të bëhet ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e nenit 3 paragrafit 1 nënparagrafit 1.5 të Rregulloresë Nr.19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civilë.

VI. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Shtimës, mban evidencën e pushimeve të nëpunësve civil në kopje fizike dhe sistemin elektronik. Gjatë vitit 2017 kanë shfrytëzuar pushime mjekësore tetë (8) nëpunës civil dhe tre (3) pushime pa pagesë. Të gjitha pushimet janë në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

VII. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Shtimës, ka pas një (1) transferim të përhershme të brendshme. Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me numër 02Nr.02 të datës 04.01.2017 për transferimin e përhershëm të nëpunëses nga pozita “Zyrtar për Zhvillim” në kuadër të Drejtorisë për Zhvillimin Ekonomik në vendine punës “Zyrtar i Prokurimit”

në kuadër të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshëm, i cili transferimi është zhvilluar në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civilë si dhe të dispozitave të nenit 8 të Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

VIII. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Shtimës, ka të punësuar 92 shqiptar, 1 boshnjak dhe 1 ashkali.

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar edhe numrin e të punësuarve në aspektin gjinor dhe ka konstatuar se në Komunën e Shtimës, 26 e të punësuarve janë femra dhe 68 e të punësuarëve janë meshkuj.

Po ashtu Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar edhe numrin e të punësuarëve të nëpunësve me nevoja të veçanta, dhe ka konstatuar se në Komunën e Shtimës nuk ka asnjë nëpunës me nevoj të veçanta.

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 94 nëpunësve civil të punësuar në Komunën e Shtimës 26 prej tyre janë femra ndërsa 68 meshkuj, çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

REKOMANDIMI 2:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Shtimës, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 94 nëpunësve civil të punësuar në Komunën e Shtimës asnjë prej tyre nuk është me aftësi të veçanta, me çka nënkuptohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, sipas të cilës dispozitë është përcaktuar që „Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor”.

REKOMANDIMI 3:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Shtimës, që ti ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara pasi që çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.

IX. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Shtimës gjatë vitit 2017 ka pasur, dy (2) nëpunës civil me pezullim të dakorduar, tre (3) nëpunës civil pushim pa pagesë, dy (2) nëpunës civil për marrjen e detyrës së funksionarit publik dhe

një (1) përfundime të marrëdhënies së punës është bërë për shkak të arritjes së moshës së pensionimit dhe iu është bërë kompensimi i një page përcjellëse.

E GJETURA: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar, se nëpunësja civile në vendine punës “Përgjegjëse për Punë të Përgjithshme dhe Udhëheqëjen e Ndërrimeve në Operatorin Kadastral”, iu është lëjuar pezullii i dakorduar i marrëdhënies së punës edhe pse nuk ka parashtrur kërkesë për pezullim të marrëdhënies së punës.

REKOMANDIMI 3:

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës së Shtimës, që ti ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e nenit 89 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

X. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Komunën e Shtimës gjatë vitit 2017 nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mban ndonjë postë publik e që do të ishte në papajtueshmëri me ushtrimin e detyrës së nëpunësit civil.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XI. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Komunën e Shtimës gjatë vitit 2017 nuk ka pasur asnjë nëpunës që ndaj tij është zhvilluar ndonjë procedurë penale ose është dënuar me vendim të gjykatës.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XII. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVILË

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Shtimës për vitin 2017 ka hartuar “Planin e trajnimeve”, dhe është dorëzuar në Ministrinë e Administratës Publike në shkurt të vitit 2017.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XIII. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Shtimës, vijimin në punë e mban në formë elektronike, nëpunësit civil kompensohen vetëm me rastin e pensionimit dhe zyrtari për teknologji informative.

Për këtë fushë të mbikëqyrjes, nuk kemi pasur rekomandime.

XIV. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Komuna e Shtimës në vitin 2017 nuk ka qenë subjekt i monitorimit për vitin 2016 dhe ka zbatuar vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ndaj vendimit me numër A/02/132/2017 të datës 21.04.2017 ka ngrit padi pranë Gjykatës kompetente.

XV. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLUZIONET E PËRGJITHSHËM PËR MIBKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit dhe monitorimit të të dhënave të dosjeve për fushat e mbikqyrjes në Komuna e Shtimës, ka konstatuar katër (4) të gjetura dhe ka dhënë katër (4) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Komunës së Shtimës, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.

Lela Petković

Kryetare e Kolegjit



Valentina Kaçandolli Bekteshi

Bashkëpunëtore Profesionale